

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Zurich Investment Group" Sh.p.k.**

Sot më datë 18.06.2021, Z. Alban Efthimi, shtetas shqiptar, lindur më date 13.10.1970 në Tiranë dhe banues në Tirane me mjet identifikimi Karte Identiteti me nr. personal H01013093A, ka vendosur nepermjet ketij akti themelimi, te themeloje një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga Statuti i saj.

**NENI 1  
EMËRTIMI**

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është **"Zurich Investment Group" Sh.p.k.** më poshtë e quajtur "Shoqëria".
- 1.2 Shoqëria themelohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar.

**NENI 2  
SELIA**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tirane, Shqipëri, në adresën: Rruga e Kosovareve, Pallati "Dolçka", Apartamenti ½, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë.

**NENI 3  
KOHËZGJATJA**

- 3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me afat të papërcaktuar.

**NENI 4  
OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti aktivitetet e percaktuara ne Statutin e saj.

**NENI 5  
KAPITALI THEMELTAR**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 Lekë (njëqind). Kapitali themeltar është nënshkruar tërësisht nga ortaku i vetem themelues, Z. Alban Efthimi, i cili është zotërues i një kuote që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar, e barabarte me 100 Lek (njëqind);

**NENI 6  
ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

- 6.1 Asambleja e Ortakëve, e thirrur në pajtim me ligjin dhe rregullisht e mbledhur, përfaqëson të gjithë ortakët dhe është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, të marra në përputhje me ligjin dhe statutin detyrojnë të gjithë ortakët rregullisht të mbledhur, që kanë marrë pjesë apo kanë votuar kundër.

**NENI 7  
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

- 7.1 Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili ka kompetencat e përfaqësimit të Shoqërisë dhe kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të



jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me ligjin nr. 9901, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe statutin e Shoqërisë.


7.2

**NENI 8  
TE NDRYSHME**

- 8.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj tregtar në përputhje me këtë Statut dhe me legjislacionin shqiptar. Ligji shqiptar "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar do të rregullojë rastet që nuk parashikohen në këtë Akt Themelimi.
- 8.2 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

ORTAKU I VETEM THEMELUESME VULLNET TE LIRE E TE PLOTE E NËNSHKRUAN KETE AKT THEMIELIMI TE SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR "Zurich Investment Group" SHPK

**Alban Efthimi**



**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

